

PROCESVERBAL
nga seanca e 17-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 16.04.2025

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë përmes lidhjes video-konferencë:
Lazo Petrushevski kryetar i Këshilli të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshilli të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshilli të Agjencisë: /

Në seancë përmes lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të parishëm nga Shërbimi Profesional përmes lidhjes video-konferencë:
dr. Ivana Stojanovska, Cvetanka Mitrevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Goran Radunoviq, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski hapi seancën e 17-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në orën 14:05 dhe u mbaj përmes lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 16-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 10.04.2025.
2. Propozim për ndalimin e procedurës së inicuar për SHTR TV SONCE SHPKNJP Prilep.
3. Propozim-vendim për heqjen e lejes për transmetim TV të SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj, Shkup.
4. Propozim-aktvendim për fshirje nga regjistri i transmetuesve të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës RADIO UNIVERSITARE UGD FM.
5. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik për lëndën në vijim të furnizimit publik – shërbim: Mbajtja e higjienës në ambientet zyrtare të Agjencisë..

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 16-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 10.04.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Trajçevski ka shpjeguar Propozimin për ndalimin e procedurës së inicuar për SHTR TV SONCE SHPKNJP Prilep. Ai ka shpjeguar se transmetuesi, pas inicimit të procedurës nga Këshilli për heqjen e lejes për transmetim televiziv, gjatë javës së kaluar ka kryer pagesën e borxhit në tërësi, përkatësisht ka paguar faturën për kompensimin vjetor për transmetim televiziv. Prandaj, është propozuar që procedura për heqjen e lejes të ndalet.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI SONCE SHPKNJP Prilep, PA1 nr.08-141 datë 18.03.2019.

Në pajtim me Njoftimin për pagesën e kryer nr.05-1608/2 datë 11.04.2025, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI SONCE SHPKNJP Prilep, kompensimin vjetor për lejen e transmetimit televiziv e kapaguar në tërësi, sipas faturës së dorëzuar nr.2025-100-0084 datë 25.02.2025.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e lartpërmenduar ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 3

Z. Trajçevski ka shpjeguar Propozim-vendimin për heqjen e lejes për transmetim TV të SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj, Shkup. Ai ka sqaruar se njëjtë si dhe në rastin e transmetuesit të mëparshëm, Këshilli ka inicuar procedurë për heqjen e lejes. Në ditën kur është mbajtur seanca për inicimin e procedurës, Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ka marrë njoftim nga Agjencia e Punësimit, sipas së cilës numri i të punësuarve në televizion ishte 18, që është nën minimumin ligjor prej 20 punonjës, të përcaktuar në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio. Ndërkohë, javën e kaluar është kryer një verifikim, gjatë të cilit është konstatuar se numri i të punësuarve është vetëm një, që paraqet shkelje serioze të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio. Gjithashtu, transmetuesi nuk ka shlyer detyrimin për pagesën e kompensimit vjetor për transmetim televiziv. Duke pasur parasysh këto dy arsye – mospagesë të kompensimit dhe mospërbushjen e kushteve minimale kadrovike, propozohet që leja për transmetim televiziv t'i hiqet. Në fund Z. Trajçevski theksoi se fatkeqësisht, përvoja e deritanishme ka treguar se modeli i të ashtuquajturave „televizione partiake“ është i paqëndrueshëm dhe shpreson se do ta kuptojnë edhe partitë politike.

Z. Petrushevski theksoi se, duka marrë parasysh hapat e ndërmarrë nga transmetuesi, si mospagesa e kompensimit vjetor dhe largimi i të punësuarve, është e qartë se qëllimi i themeluesit kanë për qëllim mbylljen e televizionit dhe shprehu keqardhje për një situatë të tillë.

Z. Fidanoski theksoi se, se kur ky medium hyri në tregun mediatik maqedonas, kishte deklarata ambicioze se do të përfaqësojë projekt serioz dhe cilësor mediatik. Ai gjithashtu tha se sinjerisht u gëzohej deklaratave të tilla, në veçanti dhe vetë vjen nga ai rajon (fellë) dhe çdo hapje të një media të re e percepton si një zhvillim pozitiv. Ai përkujtoi se ka pasur një investim të rëndësishëm në infrastrukturë në rrethinën e Shkupit dhe në resurse të tjera, që shtesë e rrit shpresën se ishte një projekt afatgjatë. Ai shprehu keqardhjen që televizioni është vënë në situatë që të shuhet. Megjithatë, ai shtoi se sinjerisht beson se një hapësirë e tillë mediatike nuk do të mbetet bosh dhe se shumë shpejt do të shfaqet një subjekt i ri i interesuar që do të dëshirojë të konkurrojë në mënyrë të barabartë në skenën mediatike.

Z. Trajčevski tha se do të japë një sqarim. Ai shpjegoi se është i njëjti person juridik që ka hyrë në tregun mediatik në vitin 2017 ose 2018, por në realitet, vitin e kaluar ka pasur probleme serioze me strukturën e pronësisë të atij mediumi, strukturë që në thelb asnjëherë nuk u realizua siç ishte planifikuar. Ai deklaroi se mediumi aktual është formalisht i njëjti me atë të disa viteve më parë, por në thelb kemi të bëjmë me subjekt krejtësisht të ndryshëm, në kuptimin e njerëzve që qëndrojnë pas tij dhe mënyrën se si funksionon.

Z. Ajdini shprehu keqardhje që një media e madhe në vend po shuhet në këtë mënyrë. Ai vuri në dukje se ndjen keqardhje për investimin e përgjithshëm, si kadrovik ashtu edhe teknik, si dhe për numrin e madh të punënjësve, disa prej të cilëve i njeh personalisht. Ai përkujtoi se, siç theksoi dhe Z. Fidanoski, kishte pritshmëri që ky medium të shndërrohej në një lojtar serioz në tregun mediatik në vend. Ai theksoi se Agjencia, e veçanërisht dhe ai personalisht, janë përpjekur të rivendosin bashkëpunim me transmetuesin dhe në një farë mënyre të ndihmojnë mbajtje të funksionimit të tij, por fatkeqësisht, ato përpjekje nuk kanë dhënë fryte. Në fund ai shprehu edhe një herë keqardhje për heqjen e lejes për transmetim.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv, PA1 nr.08-128 datë 13.03.2017 të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KLAN MAQEDONI SHPKNJ eksport – import Saraj, Shkup, seapse pas dhënies së lejes janë paraqitur situata që paraqesin pengesa ligjore për zotëruesin e lejes për kryerjen e veprimtarisë, përkatësisht për shkak se transmetuesi nuk ka plotësuar kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për dhënie e lejes për transmetim televiziv dhe radio dhe nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv në afatin e përcaktuar ligjor prej – 30 ditësh nga dita e pranimit të Faturës nr.2025-100-0086 datë 28.02.2025 (nr ynë.ark.05-830/1 datë 28.02.2025).

Fatura 2025-100-0086 datë 28.02.2025 (nr ynë.ark.05-830/1 datë 28.02.2025), anulohet dhe subjektit, shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KLAN MAQEDONI SHPKNJ eksport – import Saraj, i jipet (lëshohet) faturë e re, që i referohet vetëm periudhës së punës, përkatësisht nga dita e marrjes së Vendimit për heqjen e lejes, që duhet paguar jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies së Vendimit.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmendur ta publikon në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, në ueb faqen e Agjencisë dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësive joshumocë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pika 4

Z. Trajçevski shpjegoi Propozim-aktvendimi për fshirje nga Regjistri i transmetuesve të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës RADIO UNIVERSITARE UGD FM. Ai shpjegoi se gjatë mbikëqyrjes së realizuar është konstatuar se radio transmeton ekskluzivisht program muzikor, që është në kundërshtim me konceptin e miratuar programor. Ai theksoi se është mbajtur takim me përfaqësues të radios, gjegjësisht me Universitetin „Goce Dellçev“ – Shtip, ku janë treguar mënyrat dhe mundësitë që duhet të përmbushen që radio të funksionojë në pajtim me konceptin të dorëzuar Agjencisë. Megjithatë, Universiteti, përkatësisht Këshilli i universitetit, ka marrë vendim për ndalim me transmetim tokësor dhe se radio do të vazhdojë të funksionojë ekskluzivisht përmes platformave digjitale të internetit. Z. Trajçevski shprehu keqardhjen që një universitet që në programet e studimit ka drejtime për gazetari, nuk arriti të mbajë gjallë mediumin në formë tradicionale, tokësore.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për fshirje nga regjistri i transmetuesve të Republikës së Maqedonisë së Veriut – Universitet Shtetëror „Goce Dellçev“ Shtip – Institucion Radiodifuziv Jofitimprurës RADIO UNIVERSITARE UGD FM.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 5

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, znj. Cvetanka Mitrevska ka shpjeguar Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik për lëndën: shërbim – mbajtja e higjienës në ambientet zyrtare të Agjencisë. Ajo theksoi se bëhet fjalë për furnizim që është paraparë në Planin Vjetor për furnizim publik, ndërsa mjetet për realizimin e tyre sigurohen në Planin Financiar për vitin 2025. Duke marrë parasysh vlerën e parashikuar, furnizimi do të zbatohet si procedurë e thjeshtë e hapur, në pajtim me dispozitat e Ligjit për furnizim publik që i referohet këtij lloji të procedurës. Kontrata që rezulton nga ky furnizim do të lidhet për një periudhë njëvjeçare. Procedura për furnizim publik do të fillojë me publikimin e shpalljes përmes sistemit elektronik për furnizime publike, si dhe me publikimin e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Znj. Mitrevska informoi se të gjitha informatat shtesë lidhur me furnizimin janë të përfshira në materialet që u janë ofruar anëtarëve të Këshillit. Për seancë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Mirëmbajtja e higjienës në ambientet zyrtare të Agjencisë.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: mirëmbajtja e higjienës në ambientet zyrtare të Agjencisë, është parashikuar dhe është në pajtim me Planin Financiar për furnizim publik për vitin 2025 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.05-5321/1 datë 27.12.2024, ndërsa mjetet janë siguruar me Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

